



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 5 datë 29-1- 2026

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, me 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për vitin 2026.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar . Ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026, Ligji nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017 të Ministrit të Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar. Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1-Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

Përfitues të fondit 6% do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndihmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohen nga Administratorët Shoqërorë
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje Rome dhe Egjiptiane.

6. Vajza-Nëna në nevojë.
7. Familje të cilat kanë, probleme të ndryshme sociale (dhunë në familje, divorci, probleme shëndetësore, fatkeqësi natyrore, probleme me dokumentacionin në përmbushje të kriterëve që përcakton ligji Nr.57 /2022 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”)

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social** dhe **Drejtoria e Financës, buxhetit dhe MFK**

3-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI



KRYETAR

Ana Verushi



Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-1-2026